

**AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**"VETRO METAL MONTAGGI" SH.P.K.**

Sot, më date **24.01.2022**, une i nënshkruari:

- **Olgert Dingozi** lindur me 03/11/1988, ne Lushnje dhe me residence ne Lushnje, shtetas Shqiptar i identifikuar nepermjet pasaportes me nr.**BA2250697** , madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar....; në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*" kam vendosur të themeloje një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emëruar "**VETRO METAL MONTAGGI**" SH.P.K. (më poshtë referuar si "Shoqëria"), duke nënshkruar këtë Akt Themelimi. Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet nga Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij Akti Themelimi dhe i bashkëngjitet si Shtojca 1.

**Neni 1**

Emri i Shoqërisë është: "**VETRO METAL MONTAGGI**" SH.P.K.

**Neni 2**

(1) Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Lushnje, Fshati Kurtine, lagja "Qender" , rruga e Dingozeve, godine 1 kateshe me nr.pasurie 399/56, zone kadastrale nr.2342 .

(2) Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: [mvetrometal@gmail.com](mailto:mvetrometal@gmail.com)

Shoqëria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise.

**Neni 3**

-Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë 10 vjet dhe fillon që prej dates se regjistrimit te saj ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare ne Qendren Kombetare te Biznesit.

**Neni 4**

**Objekti**

Shoqëria do të kryej aktivitetin e mëposhtëm :

- a. Montim fasade, dyer-dritare, etje .

-Megjithate shoqëria ka te drejte qe te shtoje dhe te ndryshoje objektin e veprimtarise se saj me vendim te asamblese se ortakeve.

**Neni 5**

**Kapitali themeltar**

(1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 1 000 000 (nji milion) Lekë

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues **Z. Olgert Digozi** : Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme prej 1 000 000 (nji milion) Leke që përbën 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

*Olgert Dingozi*  


Kontributi i ortakëve do të jetë në para.

#### Neni 6:

##### Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Shtimi ose pakesimi i kapitalit themelor mund të behet vetem pasi Asambleja e ortakëve me shumice e ka dekretuar këtë dhe për më tepër të gjithë ortakët janë të detyruar që ta repektojnë dhe të kontribuojnë në para ose në natyrë në baze të vendimit të shumicës së asamblese

#### Neni 7:

##### Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen përmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë
- b) shitblerjes;(me të drejtën e parablerjes nga ana e ortakëve).
- c) trashëgimise;
- d) dhurimit;
- e) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë ligjerisht të transferueshme ndërmjet ortakëve,përsa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltare janë ligjerisht të transferueshme me rrugë trashgimnie.

#### Neni 8

##### Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, kuorumi, marrja e vendimeve ,përfashtimi nga e drejta e votës dhe të tjera modalitete për funksionimin e organit vendimmarres përcaktohen në statutin e shoqërisë.

#### Neni 9

##### Administrimi

Administrator i shoqërisë emrohet z.Bektash Dingozi lindur me 27/03/1967, në Hysgjokaj dhe me rezidence në Lushnje, shtetas Shqiptar i identifikuar nepermjet leternjoftimit nr.035431628, madhor me zotesi të plote juridike për të vepruar, i zgjedhur për një periudhë 5 vjecare me të drejte rizgjedhje.

Kompetencat dhe përgjegjësitë e Administratorit janë të përcaktuara qarte në statutin e shoqërisë.

Dingozi Bektash

## Neni 10

### Viti financiar-ekspertët

Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përgjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar pregatit raportin me shkrim për nxierien e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që tja paraqesë e ta dorëzojë në kohë ortakëve për ti shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

## Neni 11

### Prishja-riorganizimi i shoqërisë

Modalitetet për prishjen dhe riorganizimin e shoqërisë janë të percaktuara në statutin e shoqërisë në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

## Neni 12

Akti i Themelimit është hartuar në 4 kopje origjinale.

**ORTAKU I VETEM I SHOQERISE**

**Olgert Dingozi**

*Olgert Dingozi*  
